REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT**
**ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN**

**Nr.** 599 **Prot.** **Laç, me 22.02.2022**

**VENDIM**
**mbi**
**Njoftimin me shpallje publike per palen debitore**

Ne Lac,sot me date 22.02.2022.

Une,Mikeda Cenaj,me detyre Permbarues Gjyqesore prane Zyres Permbarimore Kurbin, pasi studiova aktet proçeduriale te çeshtjeve permbarimore Nr.288 rregjistri themeltar te vitit 2022 bazuar ne Urdherin e ekzekutimit nr.2111(1749) te dates 22.09.2021 Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Korce,

**KONSTATOVA:**

Se ne date 20.01.2022 eshte depozituar prane Zyres se Permbarimit kerkesa e kreditorit Drejtoria Vendore per Kufirin dhe Migracionin Korce se bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" te Titullit Ekzekutiv (Procesverbal I konstatimit te kundravajtjes) nr.0007861 date 12.12.2019 te Drejtorise Rajonale per Kufirin dhe Migracionin , me pale dhe objekt :

-Kreditor:Drejtoria Vendore per Kufirin dhe Migracionin Korce.
-Debitor: Mirush Hasan Ferra i dtj.10.01.1991 me banim ne Nd.34,H.1,Tarazhi,Mamurras.
-Me Objekt: Pagim gjobe administrative në vlerën 10.000- lekë + 1200 leke TFP & TVSh,ne total 11.200 (njembedhjetemije e dyqind) - lekë.

Nga ana e zyre tone permbarimore kane filluar procedurat ne baze te nenit 515 e vijues te K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 date 18/01/2001"Per Organizimin dhe Funksionimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor"i ndryshuar per ekzekutimin e detyrueshem te Titullit Ekzekutiv te sipercituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone ne bashkepunim me organet kompetente rezulton se debitori Mirush Hasan Ferra nuk merr dijeni per aktet permbarimore nepermjet sherbimit postar pasi rezulton i panjohur sipas tyre ndersa sipas shkreses zyrtare te Z.GJ.CIVILE Mamurras eshte banor i kesaj zyre.Ne keto kushte si rezultat i kesaj bazuar ne nenin 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 te K.Pr.Civile lind e nevojshme te procedohet me njoftimin me shpallje publike te debitorit lidhur me detyrimin qe ai ka ndaj pales kreditore DVKM KORCE per gjoben administrative dhe tarifat fikse permbarimore ne 11200 leke.

Sa me siper ne mbeshtetje te Nenit 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 te Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 date 18/01/2001"Per Organizimin dhe Funksionimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor",i ndryshuar

***VENDOSA***

**1**-Te kryej njoftimin nepermjet shpalljes publike me afat 20 (njezet) ditor (duke mare parasysh edhe komunikimin postar) nga data 22/02/2022 - 13/03/2022 te debitorit Mirush Hasan Ferra i dtj.10.01.1991 me banim ne Nd.34,H.1,Tarazhi,Mamurras.

**2**-Ky vendim perpilohet ne disa kopje,ku nje kopje afishohet ne vendbanimin e fundit te pales debitore,nje kopje afishohet ne kendin e njoftimeve te kesaj zyre, nje kopje dergohet per afishim ne ambjentet e Bashkise Kurbin/Njesise perberese ,nje kopje dergohet per afishim ne ambjentet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe nje kopje i dergohet per publikim ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Permbarimit Tirane.

**3**-Kjo shpallje publike ka vleren e aktit te njoftimit per palen debitore Mirush Hasan Ferra i dtj.10.01.1991 me banim ne Nd.34,H.1,Tarazhi,Mamurras dhe me kalimin e ketij afati pala konsiderohet i njoftuar.

**4**-Pala debitore Mirush Hasan Ferra,duhet te paraqitet prane Zyres Permbarimore Kurbin me seli ne Lgj nr.4,Lac ne katin e pare ne ambjentet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe te marre kontakt me permbaruesin gjyqesor te ceshtjes permbarimore per t'ju vene ne dispozicion aktet permbarimore,pasi me kalimin e ketij afati do te vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve te nenit 519 e ne vijim te K.Pr.Civile.

U shpall,sot me date 22.02.2022.

**PERMBARUES GJYQESOR**
**MIKEDA CENAJ**